

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

PËR

GJYKATEN E RRETHIT GJYQESOR KUKES

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kukës.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtëj e tutje Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kukës) ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e LDI-së. Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kukës do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Kukës, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të saj në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Portali I Gjykatës ofron informacion te përditësuar cdo dite mbi fushën e aktivitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Kukës. Në rubrikat e portalit pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kukës janë:

“E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kukës ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kukës dhe përkatësisht: Ligji nr. 9887, datë. 10.03.2008 “Për mbrojtjen të dhënave personale” i ndryshuar, Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

i plotë;

i saktë;

i përditësuar;

i thjeshtë në konsultim;

i kuptueshëm;

lehtësisht i aksesueshëm;

i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kukës vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit:

http://gjykata.gov.al/portal_DCKU/default.aspx dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Mbi Gjykatën:

Struktura e gjykates;

Gjykatesit ;

Avokatet e gjykates ;

Ekspertet e gjykates ;

Ndermjetesuesit ;

- Cestjet gjyqesore

Cestje civile

Cestje Penale

- Statistika

Cestjet Civile;

Cestjet Penale;

Kohezgjatja e cestjeve;

Vepra sekondare dhe denime me kusht;

- Kalendari I seancave
- Informacion mbi shortin
- Lajmerime per publikun
- Pasqyra e shtypit

- Rregullore te Gjykates
- Adresa te dobishme
- Kontakt
- Multimedia

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË MINISTRISË SË INTEGRIMIT EUROPIAN

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d			Online ne portal Publikim ne ambiente dhe stenda	Kancelari ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b			Publikim ne ambiente dhe stenda	Kancelari ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurate ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g			Online ne portal Publikim ne ambiente dhe stenda	Kancelari ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)

<p>Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik,</p> <p>orarin e punës,</p> <p>emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.</p>	<p>Neni7/1/ç</p>			<p>Online ne portal</p> <p>Publikim ne ambiente dhe stenda</p>	<p>Kancelari</p> <p>ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)</p>
<p>Mekanizmat monitorues;</p> <p>Dokumentet me tregues performance</p>	<p>Neni7/1/ dh</p>			<p>Online ne portal</p> <p>Publikim ne ambiente dhe stenda</p> <p>Shperndarje informacioni ne mediat lokale dhe kombetare</p>	<p>Kryetari</p> <p>Kancelari</p> <p>ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)</p>
<p>Shërbimet e autoritetit për publikun.</p>	<p>Neni 7/1/f</p>			<p>Online ne portal</p> <p>Publikim ne ambiente dhe stenda</p>	<p>ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)</p>
<p>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.</p>	<p>Neni 7/1/i</p>			<p>Online ne portal</p> <p>Publikim ne ambiente dhe stenda</p>	<p>ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)</p>

Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1			Online ne portal	ZMP(Zyra per marredhenie me publikun)
				Publikim ne ambiente dhe stenda	

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kukës vendos në dispozicion të publikut në portalin e saj të internetit http://gjykata.gov.al/portal_DCKU/default.aspx dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme të informacionit

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

Dt. 01/01/2015

MIRATOHET
 KRYETARI
 ISUF SHEHU

